


# Përdorimi i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Ndërmarrje

**Tiranë, më 19 Shtator 2024:** Ndërmarrjet me 10 e më shumë të punësuar që kanë përdorur kompjuter me akses në internet për qëllime pune gjatë vitit 2024, përfaqësojnë 99,3 % të ndërmarrjeve, nga 99,1 % që rezultuan në vitin 2023.

Gjatë vitit 2024, përqindja e ndërmarrjeve të cilat kanë specialistë të fushës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit është 29,7 %, nga 28,4 % që rezultoi në vitin 2023.

Të punësuarit që kanë përdorur kompjuter me akses në internet për qëllime pune përbëjnë 32,4 % të të punësuarve gjithsej të ndërmarrjeve, nga 29,9 % që rezultuan në vitin 2023. Përqindja më e lartë e të punësuarve që përdorin kompjuter me akses në internet vërehet në aktivitetin e informacionit dhe komunikimit me 74,8 %, e ndjekur nga aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike me 65,7 % dhe shërbimet administrative dhe mbështetëse me 59,1 %.

**Fig. 1 Përqindja e të punësuarve që përdorin kompjuter me akses në internet sipas aktivitetit ekonomik, 2024**



Në vitin 2024, ndërmarrjet me 250+ të punësuar përdorin 100 % kompjuter me akses në internet. Në këtë grup ndërmarrjesh, 34,3 % e të punësuarve përdorin kompjuter me akses në internet.


**Fig. 2 Përdorimi i internetit në ndërmarrje sipas madhësisë së ndërmarrjes (%), 2024**



Në vitin 2024, 99,3 % e ndërmarrjeve ka përdorur lidhje fikse në internet, e cila përfshin lidhjet e tipit ADSL, SDSL, VDSL, fibër optike (FTTP), teknologji kabllore, etj nga 99,1 % që rezultuan në vitin 2023.


Përqindja e ndërmarrjeve që kanë patur shpejtësinë e shkarkimit të informacionit më të lartë se 30 Mbit/s është 88,0 %, nga 83,5 % që ishte në vitin 2023, ndërsa përqindja e ndërmarrjeve me mbi 100 Mbit/s është 40,9 %.

**Fig. 3 Shpejtësia maksimale për shkarkim (%), 2024**



Faqja e internetit (website) është përdorur nga 57,7 % e ndërmarrjeve që përdorin kompjuter me akses në internet, nga 54,9 % që rezultoi në vitin 2023.

Fig. 4 Përqindja e ndërmarrjeve që kanë faqe interneti, sipas aktivitetit ekonomik, 2024




Në vitin 2024, 24,5 % e ndërmarrjeve kanë shitur produkte/shërbime nëpërmjet faqes së internetit, aplikacioneve të dedikuara, faqeve të internetit e-commerce dhe aplikacioneve të përdorura nga ndërmarrje të ndryshme për tregti të produkteve, duke shënuar një rritje prej 9,7 %, krahasuar me vitin 2023.\*

Përlllogaritur brenda të njëjtit aktivitet ekonomik, peshën më të madhe të tregtisë elektronike e zënë ndërmarrjet që ushtrojnë aktivitet në fushën e Akomodimit dhe Shërbimit Ushqimor me 45,3 %, pasuar nga aktivitetet e Informacionit dhe Komunikimit me 38,0 % dhe Tregtia me shumicë dhe me pakicë me 36,2 %.

\*Të shihet metodologjia për llogaritjen e këtij treguesi.

Deri në vitin 2023 në këtë tregues janë përlllogaritur vetëm shitjet ku pagesa është kryer online.

Fig. 5 Ndërmarrjet që shesin produkte/shërbime on-line nëpërmjet faqeve të internetit/aplikacioneve kundrejt numrit total të ndërmarrjeve, sipas aktivitetit ekonomik (%), 2024



Tab. 1 Vlera e shitjeve neto të realizuara online në %, sipas madhësisë së ndërmarrjes ndaj shitjeve neto të realizuara gjithsej.


Madhësia e ndërmarrjes	Shitje online
250+ të punësuar	8,6
50-249 të punësuar	9,8
10-49 të punësuar	9,9
<b>Total</b>	<b>9,5</b>

**Tab. 2 Vlera e shitjeve neto të realizuara online në %, sipas aktivitetit ekonomik ndaj të shitjeve neto të realizuara gjithsej.**

Seksionet	Aktivitetet Ekonomike	Shitje Online
	<b>GJITHSEJ</b>	<b>9,5</b>
<b>C</b>	Industri përpunuese	2,2
<b>D, E</b>	Energjia elektrike, furnizimi me gaz, avull dhe ajër i kondicionuar; Furnizimi me ujë,aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	0,4
<b>F</b>	Ndërtim	3,3
<b>G</b>	Tregti me shumicë dhe pakicë, Riparimi i automobilave dhe motoçikletave	11,6
<b>H</b>	Transport dhe magazinim	18,7
<b>I</b>	Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit	10,1
<b>J</b>	Informacioni dhe Komunikacioni	40,3
<b>L</b>	Pasuritë e patundshme	1,8
<b>M (Grupet 69-74)</b>	Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike (pa përfshirë aktivitetet veterinare)	3,3
<b>N</b>	Shërbime administrative dhe mbështetëse	13,4
<b>S (Grupi 95.1)</b>	Riparimi i kompjuterëve dhe i pajisjeve të komunikimit	15,4

Media sociale (Facebook, LinkedIn, Twitter, Youtube, Twitter, Pinterest etj.) është përdorur nga 83,1 % e ndërmarrjeve që përdorin kompjuter me akses në internet, nga 80,5 % që rezultoi në vitin 2023.

**Fig. 6 Përdorimi i medias sociale në ndërmarrje sipas, sipas madhësisë së ndërmarrjes (%), 2024**



Në vitin 2024, shërbimet cloud të cilat i referohen shërbimeve që përdoren në internet për të aksesuar programe kompjuterike, kapacitete ruajtëse, etj janë përdorur nga 30,0 % e ndërmarrjeve që kanë akses në internet. Krahasuar me vitin 2023, përdorimi i shërbimeve cloud në ndërmarrjet që kanë akses në internet, ka shënuar 7,0 % rritje.

Në ndërmarrjet të cilat kanë blerë shërbimet cloud gjatë vitit 2024, 70,6 % e tyre aplikojnë software-in për menaxhimin e marrëdhënieve me klientët (CRM), i cili lehtëson komunikimin me klientin dhe ndihmon në gjurmimin e interesave të klientëve, etj. Në vitin 2024, ndarja automatike e informacionit brenda ndërmarrjes, e cila përdoret për planifikimin dhe menaxhimin e burimeve të ndërmarrjes, duke ndarë informacionin midis fushave të ndryshme funksionale është përdorur nga 40,7 % e ndërmarrjeve nga 38,8 % e ndërmarrjeve të cilat e kanë përdorur gjatë vitit 2023.

# Metodologjia

INSTAT për matjen e nivelit të treguesve të përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit ka kryer në vitin 2024 vrotimin mbi “Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit” pranë ndërmarrjeve ekonomike me 10 e më shumë të punësuar.

Termi “Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK)” i referohet teknologjive që sigurojnë akses në informacione përmes telekomunikimit. Termi TIK është i ngjashëm me termin Teknologji Informacioni (TI), por fokusohet në teknologjitë e komunikimit që përfshijnë internetin, rrjetin, celularët dhe media të tjera komunikimi.

Qëllimi i vrotimit “Anketa për Përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit” është të mbledhë dhe shpërndajë informacion të harmonizuar dhe të krahasueshëm për përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në ndërmarrje. Për matjen e përdorimit të TIK, INSTAT ka intervistuar 2,092 ndërmarrje të të gjitha formave ligjore dhe llojeve të pronësisë me 10 e më shumë të punësuar.

## ***Njësia e vrotimit***

Njësia e vrotimit është ndërmarrja me 10 e më shumë të punësuar, e rezultuar aktive nga Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve.

## ***Fusha e mbulimit***

Në vrotim u mbuluan ndërmarrjet e zgjedhura nga Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve të klasifikuara sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev.2 në nivel seksioni.

<b>Seksionet</b>	<b>Përshkrimi</b>
C	Industri përpunuese
D, E	Energjia elektrike, furnizimi me gaz, avull dhe ajër i kondicionuar; Furnizimi me ujë,aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve
F	Ndërtim
G	Tregti me shumicë dhe pakicë. Riparimi i automobilave dhe motoçikletave
H	Transport dhe magazinim
I	Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit
J	Informacioni dhe Komunikacioni
L	Pasuritë e patundshme
M (Grupet 69-74)	Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike (pa përfshirë aktivitetet veterinare)
N	Shërbime administrative dhe mbështetëse
S (Grupi 95.1)	Riparimi i kompjuterëve dhe i pajisjeve të komunikimit

### **Metoda e grumbullimit**

Grumbullimi i të dhënave është realizuar gjatë muajit Mars 2024 me anë të metodës CAPI, nëpërmjet intervistës ballë për ballë me anketues me tabletë.

Periudha e referencës për variablat kryesore është koha e mbledhjes së të dhënave, tremujori i parë i vitit 2024. Për pyetjet në lidhje me Shitje/Blerje online, specialistët TIK, vlera e xhiros së kryer nga shitjet, etj periudha referuese është një vit më parë, viti 2023.

### **Përkufizime**

**Kompjuter:** Kompjuterat përfshijnë kompjuterat personalë, tabletët apo pajisje të tjera portabël si Smartphone apo Personal Digital Assistants (PDAs).

**Akses në Internet:** Termi “Akses në Internet” i referohet një lidhjeje të jashtme në Internet përmes një kompanie që operon si Ofrues i Shërbimit në Internet (Internet Service Provider – ISP).

**Website:** Faqja e internetit është një dokument me HyperText. Ekzistenca e një website i ofron ndërmarrjes potencial për një performancë më të mire, mundësi të reja për prezantimin e ndërmarrjes, produkteve, mundësi për njohje më të madhe dhe në të njëjtën kohë aksesin në tregje të reja dhe për rrjedhojë të ardhura më të larta. Faqet e internetit mund të ketë tekst, lidhjet HyperText, imazhe, video dhe zëra.

**Media Sociale:** Përdorimi i Mediave Sociale si psh: Facebook, Google+, Twitter, YouTube etj. i referohet përdorimit nga ndërmarrja të aplikacioneve që bazohen në teknologjinë e Internetit ose në platforma komunikimi për tu lidhur, krijuar dhe shkëmbyer përmbajtje online, me kliente, furnizues, ose partnerë, jashtë ose brenda ndërmarrjes.

**EDI, tip EDI i mesazheve:** Shkëmbimi elektronik i të dhënave (EDI) i referohet transmetimit të strukturuar të të dhënave ose dokumenteve ndërmjet organizatave ose ndërmarrjeve me anë të mjeteve elektronike. Ai gjithashtu i referohet posaçërisht një familje standardesh (të tipit EDI) dhe mesazheve të tipit EDI të përshtatshme për përpunim të automatizuar.

**\*Shitjet Online:** Janë shitjet e bëra nëpërmjet një dyqani në internet (web shop), nëpërmjet formularëve në web në një faqe interneti ose ekstranet, ose aplikacione pavarësisht se si aksesohet në web (kompjuter, laptop, telefon celular etj.). Pagesa mund të bëhet online ose offline (paguaj në dorëzim të porosisë).

Deri në vitin 2023 në këtë tregues janë përlogaritur vetëm shitjet ku pagesa është kryer online.

**Pagesa në internet:** Një pagesë në internet është një transaksion i integruar porosi-pagesë.

**Specialistë TIK:** Konsiderohen ata punonjës të cilët si detyrë kryesore kanë të zhvillojnë, operojnë apo të mirëmbajnë sisteme dhe aplikacione TIK, të tillë si: specialistë të bazës së të dhënave, specialistë të mbështetjes ndaj TIK-ut, etj. Specialistët TIK kanë aftësitë përkatëse për të specifikuar, projektuar, instaluar, mbështetur, menaxhuar, vlerësuar ose kryer aktivitete kërkimore.

**Shërbimet cloud:** I referohen shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, që përdoren në internet për të aksesuar programe kompjuterike, kapacitete ruajtëse, etj. Cloud Computing është një model për të mundësuar hyrje të kudo gjendur, të përshtatshme, në bazë të kërkesës, në një grup të përbashkët burimesh kompjuterike të konfigurueshme (p.sh. rrjetet, serverat, hapësira ruajtëse, aplikacionet dhe shërbimet) që mund të sigurohen me shpejtësi dhe të lirohen me përpjekje ose shërbim minimal të menaxhimit ose të ndërveprimit të ofruesit.

**Ndarja automatike e informacionit brenda ndërmarrjes:** Një paketë programesh kompjuterike, e cila përdoret për planifikimin dhe menaxhimin e burimeve të ndërmarrjes, duke ndarë informacionet midis fushave të ndryshme funksionale (p.sh. kontabilitet, planifikim, prodhim, marketing, etj). Softueri ERP mund të jetë softuer i përshtatur për nevojat e ndërmarrjes ose softuer i krijuar vetë.

**Software-i CRM:** I referohet çdo aplikacioni software për menaxhimin e informacionit rreth klientëve (p.sh. marrëdhëniet ose transaksionet). CRM lehtëson komunikimin me klientin dhe ndihmon në gjurmimin e interesave të klientëve, etj.